



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

**VENDIM**

**Nr. 242, datë 29.10.2019**

**PËR  
SHQYRTIMIN E KËRKESËS PËR RIKTHIMIN NË DETYRË  
TË GJYQTARIT Z. {...}**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenin 97, 98, 100 të ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” në nenin 151 e vijues të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në nenin 36/3 të Kodit të Procedurës Civile, në nenin 66 të Kodit të Procedurës Administrative, në propozimin e Komisionit për Zhvillimin e Karrierës,

**VENDOSI:**

1. Pezullimin e shqyrtimit të kërkesave të paraqitura nga gjyqtari z. {...}, për rikthimin e tij në funksionin e kryetarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë dhe në detyrën e gjyqtarit për shkak se kërkesat janë për shqyrtim para Gjykatës Administrative të Apelit.
2. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, bashkë me vendimin përfundimtar.
3. Një kopje e këtij vendimi t’i njoftohet z. {...}

Ky vendim hyn në fuqi në datën e botimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

**PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**